REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
ZYRA E STREHIMIT

Nr.305 Prot

Maliq, më 22.1.2026

PROJEKT-VENDIM - NR. 8
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I QIRASË PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM Nr.459 datë.3.7.2019 "*Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin*", VKM Nr. 362, datë 29.5.2019 "*Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij*", VKB Nr.03 datë 08.01.2026 *Rishqyrtimi i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq Nr.148 datë 24.12.2025 për "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për Vitin 2026*", VKB nr.139 datë 26.11.2025 për "*Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.91 datë 31.08.2023 për "*Miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Maliq*" si dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.158 datë 26.03.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisëMaliq*", Vendimit të Komisionit të Strehimit Nr.01 datë 20.01.2026 "*Për hartimin e listës së përfituesve nga programin i strehimit social "Subvencionimi i Qirasë", Viti 2026*", Këshillit të Bashkisë Maliq i

PROPOZOJMË

1. Të miratojë listën e aplikantëve që do të përfitojnë nga programi i subvencionit të qirasë, për vitin 2026 sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur.
2. Lista përbëhet nga 4 familje, me kosto totale prej 404250 lekë, nga të cilat 80850 (tetëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë do të financohet nga bashkia Maliq përkatësisht 20% të vlerës totale si dhe 323400 (treqind e njëzet e tre mijë e katërqind) lekë do të aplikohet për financim nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, në masën 80% të shumës totale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit dhe drejtoria e Finances dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", *i ndryshuar*.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Specialist Zyre Strehimi	I. Shkëmbi		Dt. 21/01/2026
Përgjegjësi Sektori Strehimi	L.Mullalli		Dt. 21/01/2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
ZYRA E STREHIMIT

Nr.____Prot

Maliq, më 22.01.2026

RELACION
Mbi Projekt-Vendimin
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I QIRASË PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM Nr.459 datë.3.7.2019 "*Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin*", VKM Nr. 362, datë 29.5.2019 "*Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij*", VKB Nr.03 datë 08.01.2026 *Rishqyrtimi i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq Nr.148 datë 24.12.2025 për "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për Vitin 2026*", VKB nr.139 datë 26.11.2025 për "*Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.91 datë 31.08.2023 për "*Miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Maliq*" si dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.158 datë 26.03.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisëMaliq*", Vendimit të Komisionit të Strehimit Nr.01 datë 20.01.2026 "*Për hartimin e listës së përfituesve nga programin i strehimit social "Subvencionimi i Qirasë", Viti 2026.*

Ky projekt-vendim ka për qëllim miratimin e listës së përfituesve nga programi i strehimit social "Subvencionimi i Qirasë" për vitin 2026, për familjet dhe individët që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe sociale dhe që nuk përballojnë kostot e qirasë në tregun e lirë të strehimit.
Projekt-vendimi synon garantimin e së drejtës për strehim, mbrojtjen sociale të shtresave në nevojë dhe zbatimin e politikave publike të strehimit social në nivel vendor, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, gjatë vitit 2025 janë administruar 4 kërkesa nga aplikantët për përfitim nga programi i subvencionimit të qirasë për vitin 2026.
Komisioni i Strehimit, në mbledhjen e datës 20.01.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët dhe ka kryer vlerësimin sipas sistemit të pikëzimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
Nga verifikimi administrativ dhe social rezulton se të 4 familjet aplikante përmbushin kriteret ligjore për përfitim, të cilat i përkasin kategorive prioritare sipas nenit 16 të ligjit nr. 22/2018, i

ndyshuar si familje njëprindërore, familje pa të ardhura, persona të moshuar dhe familje në nevojë.
Lista e përfituesve, e përfshirë në Tabelën nr. 1 bashkëlidhur projekt-vendimit, përbëhet nga 4 familje, të vlerësuara dhe renditura me pikëzim nga 23 deri në 30 pikë, në përputhje me kriteret ligjore dhe sociale.
Kostoja totale vjetore e programit të subvencionimit të qirasë për këto familje është 404250 lekë, nga të cilat:
80% (323,400 lekë) do të aplikohet për financim nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë përgjegjëse për strehimin, pasi kjo e fundit të hapë thirrjen për aplikim për projektet e strehimit si dhe 20% (80,850 lekë) do të financohet nga buxheti i Bashkisë Maliq.
Ky financim është i parashikuar në buxhetin e miratuar për vitin 2026 dhe nuk krijon detyrime shtesë jashtë planifikimit buxhetor.

Llogaritja e subvencionit të qirasë është bërë bazuar VKM Nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" si dhe VKB nr.139 datë 26.11.2025 për "*Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

Formula e përgjithshme e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë është:

S = Qr-A x Ap ku Qr</= Qm

a) S: është vlera e subvencionit;

b) A: janë të ardhurat e familjes;

c) Ap: është aftësia përballuese e familjes, sipas nenit 3 të ligjit nr. 22/2018;

ç) Qm: është vlera mesatare e qirave të banesave në tregun e lirë, sipas pikës 36, të nenit 2, të këtij ligji;

d) Qr: është qiraja reale e përcaktuar në pikën 35, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018.

Vlera e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për një njësi të caktuar të qeverisjes vendore luhatet nga 0 deri në 100%, në varësi të të ardhurave të familjes. Për një vlerë qiraje Qr, vlerat maksimale dhe minimale të subvencionimit të strehimit, në varësi të të ardhurave të familjes, llogariten sipas formulës së mësipërme.Periudha e subvencionit është llogaritur për 11 muaj bazuar nenit 39 pika 4 të ligjit 22/2018 i ndryshuar ku thuhet se: "*Subvencioni i qirasë i jepet përfituesit bazuar në kontratën e qirasë të lidhur me pronarin social nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore*".

Ky projekt-vendim kontribuon në mbrojtjen sociale dhe garantimin e strehimit për familjet në nevojë si dhe është në përputhje me politikat e strehimit social dhe mundësitë financiare të Bashkisë Maliq.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Specialist Zyre Strehimi	I. Shkëmbi		Dt. 21/01/2026
Përgjegjësi Sektori Strehimi	L.Mullalli		Dt. 21/01/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Tabela Nr.1
Lista e aplikantëve që do të përfitojnë nga programi i subvencionit të qirasë, për vitin 2026

Nr	Emër	Mbiemër	Atësi	Kategoria sipas nenit 16,të ligjit 22/2018, i ndryshuar	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që i takon	Qiraja mes. e apart. në treg për strukturën qe i takon familjes (QR≤QM)	Të ardhurat familjare mujore (A)	Kategoria (sipas pikës 45.e nenit 2 të ligjit 22/2018), i ndryshuar	Aftësia përballuese sipas nenit 3 të ligjit 22/2018, i ndryshuar (AP)	Qiraja e përballueshme	Vlera e Subvencionit maksimal në muaj (S)	Vlera totale 11 muaj
1	Dorjana	Leka	Alfred	NE/Familje njëprindërore që ka në ngarkim një fëmijë	2	1+1	7500	0	Pa te ardhura	0%	0	7500	82500
2	Zamira	Xhuti	Nevzat	NE/Familje njëprindërore që ka në ngarkim një fëmijë	3	2+1	10000	0	Pa te ardhura	0%	0	10000	110000
3	Katina	Panajoti	Mihallaq	E moshuar/ Egjiptjan/NE	1	G	5000	11573	Të ardhura shumë të ulëta	15%	750	4250	46750
4	Betrant	Mehmetllari	Myzafer	NE	5	3+1	15000	0	Pa te ardhura	0%	0	15000	165000
Totali												36 750	404 250

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Specialist Zyre Strehimi	I. Shkëmbi		Dt. 21/01/2026
Përgjegjësi Sektori Strehimi	L.Mullalli		Dt. 21/01/2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ